



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:285007
Datë: 25.09.2024
Numri i dokumentit: 06209620

C-III-15- 0607

Paditës: F S nga Prizreni i përfaqësuar nga avokati F H Sh avokat nga Prishtina.

Kundër

Të paditurës: NSH DLB „Lavërtari Blegtori”, në likuidim të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, rr. „Driton Hoxha ” 55, përfaqësuar nga N M.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Specializuar, i përberë nga Gjyqtari Kryesues Hasim Sogojeva dhe Gjyqtarët anëtar Sylejman Shumolli dhe Murat Hulaj, pas mbajtës së seancës dëgjimore publike, më dt. 08 korrik 2024, në seancë vendimmarrëse, më dt 25 shtator 2024 mori këtë :

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET si e pa bazuar ankesa/kërkesa e paditësit F S kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit për NSH „Lavërtari Blegtori ” PRZ 009- 0323, dt. 31.08.2015 .**
- II. **Secila palë i heq shpenzimet e veta të procedurës .**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Më dt. 10.09.2015, pranë DHPGJS është parashtruar ankesa/ kërkesa e H S përmes avokatit S R si paditës, kundër të paditurit në lidhje me Vendimin e Autoritetit Likuidues (AL) për NSH Lavërtari Blegtori , PRZ 009- 0323 , dt. 31.08.2015, me të cilin është refuzuar kërkesa pronësore në ngastrën nr. ..., me sipërfaqe 0.17.85ha, ngastra nr. ..., me sipërfaqe 0.64.29ha, fleta e posedimit ..., ZKD, ngastra nr. ..., me sipërfaqe 0.19.19ha, fleta e posedimit nr. ..., ZK Prizren, ngastra nr. ..., me sipërfaqe 1,29.91 fp nr. ..., ZK T, ngastra nr. .. me sipërfaqe 0.06.80 ha fp .. si e pa vlefshme

Në parashtrësë të ankesës ka theksuar se Vendimi i AL përmban shkelje esenciale të dispozitave, sepse nuk mund të ekzaminohet për shkak të mungesave, është i pa kuptueshëm dhe nuk përmban arsye lidhur me faktet vendimtare.

Ka bashkangjitur, Vendimin e AL PRZ 009- 0323, dt. 31.08.2015 .

Më dt. 10.12.2021, DHPGJS ka lëshuar Urdhër për paditësen dhe përfaqësuesin e saj për plotësimin e ankesës, kundër Vendimit të AL, ndërsa AKP-së ju është kërkuar të jep përgjigje në ankesë.

Më dt. 29.12.2021, paditësja ka dorëzuar parashtresën përmes përfaqësuesit me të cilën ka dorëzuar dëshminë për pagesën e taksës gjyqësore, mirëpo provat e kërkuara nuk i ka dorëzuar edhe pse ka pasur për obligim.

Më dt. 08.06.2022, AKP-ja, përmes përfaqësuesit të saj dorëzoi parashtresën në mbrojtje ndaj ankesës së ushtruar kundër Vendimit të AL për NSH DLB „Lavërtari dhe Blegtori ” PRZ 009- 0323, me propozim që ankesa të refuzohet.

Në parashtresë është deklaruar se NSH „Lavërtari dhe Blegtori ”, ka hyrë në procedurë të likuidimit më dt. 07.07.2014, dhe parashtruesi ka dorëzuar kërkesë kreditore te AL më dt. 18.08.2014.

Më dt. 31.08.2015, AL mori Vendimin PRZ 009- 0323, me të cilën ka refuzuar kërkesën në pretendim të ngastrës lëndore.

Vendimi AL është mbështetur në faktet dhe bazat ligjore :

- i. Parashtruesi ju është refuzuar kërkesa sipas nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, pasi është konstatuar se kërkesa nuk është mbështetur në prova të mjaftueshme.

Në parashtresë është deklaruar se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria e Vendimit të Autoritetit të likuidimit me ligjin 04/L-034, AL vlerëson se ankesa duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me ligjin nr. 04/L-034.

AKP, nuk ka bashkangjitur asnjë provë edhe pse me Urdhër ju është kërkuar dorëzimi i provave .

Paditësi pa parashtresë të veçante ka dorëzuar provat si në vijim :

- Padia e ushtruar kundër KBI „ Progres Export” për vërtetimin nuliteti të kontratës së shitblerjes para Gjykatës Komunale në Prizren, e vitti 1996
- Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 703/96, dt. 22.05.2012,
- Aktvdekje për H M S.
- Certifikata e lëshuar nga Komuna e Prizrenit., për ngastrat lëndore,
- Aktvendimi për shqyrtimin e trashëgimisë për H S nga noteri A B dt..

Më dt. 15.03.2024, DHPGJS ka lëshuar urdhër C- III- 15- 0607, me të cilin ju është kërkuar sqarime paditësit në lidhje me shqyrtimin e trashëgimisë për paraardhësit e tij dhe të deklarohet në parashtresë të mbrojtës së AKP-së.

Më dt. 26.03.2024, është dorëzuar parashtresa e paditësit F S përmes avokatit F Sh dhe me të njëjtën është precizuar kërkesa në pikëpamje subjektive, duke theksuar se si paditësi është F S dhe ka legjitimitet për të qenë palë në procedurë .

Me këtë parashtresë është dorëzuar raporti gjeodezik i ekspertit Th R , dt. 22.03.2024, pastaj Kontrata mbi këmbimin e palujatshmerive e noterizuar te noteri A B , dt., Kontrata dt. ., e hartuar te avokati M. Sh., autorizimin për përfaqësim të lëshuar nga noteri A. M. M., dt. 08.08.2017, aktvendimi për shqyrtimin e trashëgimisë dt. ., kontrata për këmbimin e pronave dt. ., kontrata për shitje të ngastrave dt. ., kontrata për dhurimin dt. ., për ngastrat nr., .., .., ZK D.

Më dt. 27.03.2024, AKP-ja ka dorëzuar parashtresën me të cilën ka dorëzuar provat:

- Formularin e kërkesë kreditore, 21.08.2014,
- Kopja e padisë dt. 27.09.1996,
- Ankesa e paditësve H S etj përmes avokatit M P,
- Dëshmia për pranimin e padisë dhe shkresave C- III- 12- 1067, dt. 12.11.2014,
- Fletat e posedimit dt. 18.09.1995, të lëshuar nga Komuna Prizren, Kontrata për dhurimin e palujatshmeris 13.03.1963,
- Certifikata ., e lëshuar nga Komuna Prizren,
- Kërkesa e AKP_së, për paditësit t. 17.04.2015,
- Vendimin e AL PRZ 009- 0323 .

Më dt. 21.05.2024, DHPGJS ka lëshuar njoftimin për palët ndërgjyqës për përfundimin e procedurës me shkrim dhe ju është dhënë mundësia të deklarohen me shkrim në argumentim të pretendimeve të tyre dhe për racionalizim të procedurës .

Më dt. 29.05.2024, AKP-ja ka dorëzuar parashtresën me të cilën është deklaruar se dorëzon të gjitha provat që disponon lidhur me rastin.

Më dt. 05.06.2024, paditësi përmes avokatit të tij ka dorëzuar parashtresën me të cilën ka theksuar se dorëzon provat të cilat veç i kishte dorëzuar më parë .

Më dt. 08.07.2024, DHPGJS ka caktuar seancë dëgjimore publike në të cilën për paditësin ka prezantuar avokati F Sh nga Prishtina ndërsa për AKP-në N M.

Në seancë dëgjimore për paditësin i autorizuari është deklaruar : Mbesim pranë padisë dhe plotësimit të saj, konsiderojmë veprimet e të paditurit janë të kundërligjshme që janë ndërmarr ndaj paditësit, pasi kontrata e shitblerjes dt., ishte e lidhur nën kërcenim, shantazh, dhe detyrim, kjo vërtetohet nga fakti se tani e paditura nuk ka provë as për kompensim, për paraardhësin e paditësit, sikundër edhe në lidhje të kontratës së dhurimit nr.. Po ashtu kontrata e dhuratës mban numrin .. dt. ., ndërsa kontrata e shitblerjes .., dt. ., që vërteton se këto kontrata janë të falsifikuara sepse sipas dallimit të numrave rendor brenda një dite e po ashtu nga shikimi i kalendarit del që kontrata e shitblerjes ishte nënshkruar në ditë vikendi, Kontratën në origjinal gjykatës ja ofrojmë në shikim të dt. 05.10.1967, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren, Fakti se këto kontrata ishin të kundërligjshme, vërtetohet me Aktgjykimin C. nr. 976/72, dt. 18.01.1973, ku paraardhësit të paditësit ju është vërtetuar e drejta e pronësisë që vërteton se paraardhësi i paditësit ka qenë pronarë deri në vitin 1964. Ndërsa në kontratë të dhurimit se kontrata ishte lidhur më dt. 16.03.1963, që vërtetohet se kjo kontratë nuk ishte ekzekutuar fare .

Përfaqësuesi i AKP-së, është deklaruar : nuk ka asnjë provë, për pretendimin se kontrata është lidhur kundër vullnetit të të ndjerit, dhe se nuk ka provë se kjo çështje e vullnetit është ngritur para Gjykatës deri në vitin 1996, Sipas të dhënave vërtetohet se ngastrat nr., ..-, dhe ., nuk janë

në pronësi të ndërmarrjes . Vetëm ngastra nr. .. dhe ., ZK D, janë në emër të ndërmarrjes, ndërsa ngastra nr. .., është shitur me negociim direkt , ndërsa ngastra nr. .. nuk evidentohet fare në emër të ndërmarrjes. Ngastra nr. .., është kërkesë e tërhequr. Ngastra nr. .. është në bashkëpronësi të personave fizik, .

Përfaqësuesi i paditësit, është deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurit për mungesë të provave sepse me provat e deponuara e paditura në mënyrë të kundërligjshme jashtë vullnetit të paraardhësit të paditësve ishte shpallur pronare e ngastrave kadastrale të paraardhësit të paditësit siç vërtetohet me aktgjykimin e viti 1972.

E paditura duke qenë në dijeni për procedurën gjyqësore, ka bërë dëm paditësit që të njëjtat të anulohen si të kundërligjshme, nga fakti se e paditura ka vepruar në tërësi me keqbesim duke disponuar me një pjesë të ngastrave edhe pse ka qenë në dijeni .

Kontrata e shitblerjes asnjëherë nuk është paguar çmimi ndonëse çmimi jo proporcional dhe nuk ka qenë as qëllimi i kohës që pasuria private ti dhurohet kësaj ndërmarrje .

Ka kërkuar që gjykata paditësin ta shpall pronarë, të ngastrave ., vendin e quajtur „K. ” me kulture arë ,klasa 3, me sipërfaqe 2469m2, pasuri shoqërore NSH Progres , ZK Prizren, ngastra nr. ., NSH progres , ZK Prizren, me sipërfaqe 05134-2, ngastra nr., ngastra nr. ., ngastra nr. ., ngastra nr. ., ZK D, , .. dhe .., .., .., .., dhe të anulohet secili vendim i Autoritetit të Likuidimit.

Gjyqtari Kryesues në seancë dëgjimore avokatit të paditësit ja përkujtoj obligimin që ka për të qartësuar në kërkesë, se cili Vendimit i AL, me shenjë dhe numër të anulohet .

Avokati F Sh, ka theksuar se numrin e Vendimit 009- 0323 .

Gjykata palëve ndërgjyqës ua dha mundësin që fjalën përfundimtare ta dorëzojnë me shkrim, që të përmbushet mundësia e secilës palë të jep shpjegime shtesë në lidhje me çështjen .

Më dt. 19 07. 2024, avokati F Sh ka dorëzuar parashtresën e fjalës përfundimtare në të cilën ka theksuar qëndrojmë panë kërkesëpadsisë, pavarësisht faktit se kërkesa ka të bëjë me ankesë kundër vendimit të AL dhe nuk ka të bëjë jo me padi të rregullt, sikundër në këtë procedurë shqyrtohet vetëm ligjshmëria e Vendimit të AL në raport me Ligjin nr. 04/L-034, dhe Shtojcën e tijje .

Në parashtresë të fjalës përfundimtare është deklaruar se ndaj paraardhësit të paditësit janë ndërmarrë veprime të kundërligjshme me rastin lidhjes së kontratës së shitblerjes dt. 05.10.1967, me nr. 212/67, që ishte lidhur me kërcenim, shantazh dhe detyrim , kjo vërtetohet edhe me faktin se e lidhjes së kontratë për dhurim.

Kontrata për dhurimin mban numrin rendor 11702, dt. 13.03.1964, ndërsa kontrata e shitblerjes ka numrin 1164/140, dt. 12.03.1964, që vërteton këto kontrata janë të falsifikuar sepse dallimet e numrave rendor që janë lidhur mbi 10 mijë kontrata brenda një dite dhe nga shënimi kalendarik del kontrata është lidhur në ditë vikendi .

Ka theksuar se me aktgjykimin C. nr. 976/72, dt. 18.01.1973, paraardhësit të paditësi ju ishte vërtetuar pronësia pastaj me certifikata- historiat të pronës të lëshuar më dt., është vërtetuar se paraardhësi i paditësit kishte qenë pronar i këtyre ngastrave deri në vitin 1964.

Bazuar nga shqyrtimi gjyqësor është vërtetuar bazueshmëria e kërkesë padisë dhe plotësimi dhe precizimi i saj .

Kontrata e dhuratës, dt., dhe kontrata e shitblerjes, dt., janë të falsifikuara sepse dallimet e numrave rendor del që janë lidhur mbi 10 mij kontrata brenda një dite.

Në aktgjykimin C. nr. 976/72, dt. 18.01.1973, është vërtetuar se paraardhësi i paditësit është pronar përsëri , lidhur me Certifikatën e dt., që vërteton se ka qenë pronar deri në vitin 1964 .

Me parashtrësë të fjalës përfundimtare ka kërkuar të aprovohet në tërësi padia e paditësit F S dhe vërtetohet se i njëjti është pronar i ngastrave kadastrale si në vijim ngastra kadastrale ., vendi i quajtur „K” arë klasa 3, me sipërfaqe 2469m², pasuri shoqërorë NSH Progres , ngastra kadastrale nr., me sipërfaqe 1361m², ngastra kadastrale nr., me sipërfaqe 1100m², ngastra kadastrale .., me sipërfaqe 1299m², ngastra kadastrle nr., me sipërfaqe 4830m², ngastra kadastrale nr. ., me sipërfaqe 412m², ngastra kadasltrale nr .., me sipërfaqe 11502m², që është në bashkëpronësi nga ½ me H. B., ngastrat nr., .., .., ..-, dhe .., Anulohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit 009- 0323.

Më dt. 24.07.2024, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën në fjalën përfundimtare me të cilat ka kundërshtuar pretendimet e paditësit . Më tej ka theksuar se paraardhësi i paditësit ka ushtruar kërkesë pronësore në procedurë të likuidimit apo kompensimin në shumën 180,000.00€, AKP bazuar në parimin e barrës së provës ka refuzuar kërkesën.

Përveç kësaj sipas nenit 268 të Ligjit për punën e bashkuar është paraparë nëse prona është bërë në pronësi shoqërore pa bazë juridike , kthimi i së njëjtës mundet të kërkohej në afatin prej 5 viteve , duke filluar nga data e marrjes në dijeni , por më së voni në afatin prej 10 viteve.. Në këtë çështje paditësi ka lëshuar afatet për kthim të pronës.

Arsyetimi Ligjor

Ankesa/Kërkesa e paditësve, nuk është e bazuar .

Dhoma e Posaçme Gjykatës Supreme, pas përfundimit të procedurës me shkrim bazuar në nenin, 40, lidhur me nenin 42 të Ligjit nr. 06/L-086, ka caktuar seancë dëgjimore publike, më dt. 08.07.2024, në mënyrë që secilës palë përveç deklarimeve me shkrim të deklarohet edhe gojë në argumentimin e pretendimeve të tyre faktike dhe juridike që kanë të bëjnë me ligjshmërinë e Vendimit të AL për NSH DLB „Lavërtari dhe Blegtori PRZ 009- 0323, dt. 31.08.2015.

DHPGJS, bëri vlerësimin e provave që palët ndërgjyqës i kanë dorëzuar me parashtrësë me shkrim, sikundër edhe pretendimet e tyre në seance dëgjimore publike dhe parashtrësë të fjalës përfundimtare dhe bazuar me të njëjtat, ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Me Vendimin e AL për NSH „Lavërtari Blegtori ” PRZ 009- 0323, është refuzuar kërkesa e H S lidhur me anulimin e kontratës dhe njohje të pronësisë mbi ngastrat nr. ..., me sipërfaqe 0.17.15ha, nr. ..., me sipërfaqe 0.64.29ha, fleta e posedimit nr. ..., ZK D, ngastra nr. ..., me sipërfaqe 0.10.19ha, fleta e posedimit .., ZK Prizren, ngastra nr. ..., me sipërfaqe 1.29.91 sipas fletës së posedimit .. ZK T ngastra nr. ..., me sipërfaqe 0.06.80ha, evidentuar sipas fletës së posedimit nr., ZK si e pavlefshme. Vendimi që është marrë nga Autoriteti i likuidimit është mbështetur në nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, për mungesë të provave .

Në arsyetim të vendimit ndër të tjera theksohet se në pamundësi të vërtetohet të drejtën pronësore qoftë edhe të ndjerit H M S ku bazohet pretendimi. Në mungesë të dëshmive të qarta se kontratat nr., dhe ., të lidhura më 16 mars 1964, për pronat në fjalë janë bërë në formë jo ligjore dhe se pretendimet e parashtruesit mbeten vetëm deklarative dhe të pa provuara. Nuk është ofruar asnjë dëshmi se kontrata janë lidhur kundër vullnetit të të ndjerit, asnjë provë se pretendimi është ngritur në gjykatë deri në vitin 1996, neni 268 i Ligjit për punën e bashkuar parashikon ., nëse pasuria e patundshme bëhet një aset shoqëror pa bazë ligjore , për kthimin e saj mund të bëhet padi brenda një periudhë prej 5 vjeçare nga data kur ndryshimi është mësuar, pra ku pronari ka kuptuar por jo më vonë se 10 vjet nga fakti që ka ndodhur ''Padia është ushtruar më 27.09.1996, pas kalimit 32 viteve nga momenti i nënshkrimit të kontratës Përkundër kësaj paditësi me asnjë provë nuk ka provuar se ai ishte në posedim të ngastrave lëndore apo ka paguar tatim në pronë.

Para marrjes së Vendimit, Autoriteti i Likuidimit më dt. 21. 04.2015, i ka dërguar parashtruesit të kërkesës përmes të cilës i ka kërkuar prova dhe informata shtesë , duke precizuar saktë ngastrat lëndore dhe historikun e ngastrave, ekspertizën gjeodezike për identifikim të pronave, vërtetimin se prona ka qenë në emër të H M S para tjetërsimit në pronësi shoqërore, vërtetimin për shqyrtim të trashëgimisë etj.

Para ushtrimit të kërkesës te Autoriteti i Likuidimit , është vërtetuar se paditësit H S, B S, B S M S, M S dhe F S, përmes avokatit F B, kanë ushtruar padi C. nr. 703/96, kundër KBI Progres në Gjykatën Komunale në Prizren, për vërtetimin e nulitetit të kontratës për dhurim të palujatshmerisë që është lidhur në mes të paraardhësit të tyre babait, gjyshit H S dhe KBI Progres Export nr., dt., dhe kontratës nr., dt..

Ky rast gjyqësor nuk është përfunduar, pasi Gjykata Komunale në Prizren, me aktvendim C. nr.703/96, dt. 23.05.2012, është shpallur jo kompetente.

Në bazë të aktvdekjes, dt. 20.08.2016, të lëshuar nga Komuna e Prizrenit, për H M S i lindur më dt., kishte vdekur më dt., ndërsa pas vetës kishte lënë bashkëshorten N S e lindur më dt., në B, dhe mbesat B, B, M, G dhe nipërit F, dhe M .

Në dëshmi të vdekjes ., për H. M. S janë shënuar edhe të dhënat për N S bashkëshortja e vdekur më dt., G S i biti ka vdekur më dt., dhe H S e reja ka vdekur më dt..

Me aktvendimin e noterit A B LRP, T nr., dt., me të cilin si trashëgimtar i H S është shpallur F G S, ndërsa trashëgimtarët tjerë janë tërheq.

Nuk ka dëshmi se është shqyrtuar trashëgimia për H S dhe G S .

Me provën e certifikatës nr., dt., të lëshuar nga Komuna e Prizrenit, sipas kërkesës së M S vërtetohet se :

Ngastra nr. . në vendin quajtur ,,...'' arë, kl3, me sipërfaqe 1.08.49ha,
Ngastra nr. ..., në vendin e quajtur ,, ..'', arë, kl3, me sipër. 0.47.85ha,
Ngastra nr. ..., në vendin e quajtur ,,...'' arë klasa 3, me sipërfaqe 0.64.29ha, fleta e posedimit .., ZK D, deri në vitin 1964, ka qenë në emër të H M S, Bazuar në kontratën e dhurimit, Vr., dt., këto ngastra kanë kaluar në pronësi shoqërore në emër të NSH KBI Progres, me vërejtje se që sipërfaqja prej 50 m2, e ngastrës ., në bazë të kontratës Vr. ., dt. ., ju janë dhënë H B nga Prizreni.

Ngastra nr. ..., gjegjësisht ., në vendin e quajtur „K. ‘ ’ arë klasa 3, me sipërfaqe 0.19.19ha, fp nr. .., ZK Prizren dhe ngastra nr. .. në vendin e quajtur „. ‘ ’ arë kl 5, me sipërfaqe 1,29.91ha, në fp 134, ZK T dhe ngastra nr. ..., në vendin e quajtur „K ‘ ’ arë kla 4, me sipër. 0.05.50 ha, fp nr. .., ZK Prizren, sipas kontratës Vr., dt., janë bartur në pronësi shoqërore KBI „Progres ’ ’

Me raportin e ekspertit të gjeodezisë, dt.20.03.2024, janë bërë identifikimi i ngastrave nr..., , ZK Prizren, ngastra nr. ..., ZK T, dhe ngastrat nr., .. dhe .., ZK D.

Eksperti ka konstatuar se në bazë të dhënave të siguruara nga Kadastrri, deri në vitin 2024, ngastra nr., në vendin e quajtur „K ’ ’ arë klasa 3, me sipërfaqe 2469, evidentohet në emër të KBI Progres , ZK Prizren, pjesa e ngastrës nr., në vendin e quajtur „K ’ ’ me sipërfaqe 1361m², evidentohet në emër të S A nga Prizreni.

Ngastra nr. ..., në vendin e quajtur „ K’’ me kulturë, arë klasa 4, me sipërfaqe 1100m², ZK Prizren është evidentuar në emër të KBI „Progres’’ dhe atë ½ pjesë dhe ½, pjesë në emër të A S.

Ngastra nr., në vendin e quajtur „.’ ’ arë kl 5, me sipërfaqe 12991m², ZK Prizren është e evidentuar në emër të KBI „Progres ’ ’ .

Ngastra nr., në vendin e quajtur „.’ ’ me sipërfaqe 4830m², ZK D , evidentohet në emër KBI „Progres ’ ’.

Ngastra nr. ..., në vendin e quajtur „.’ ’ me sipërfaqe 412m²,

Ngastra nr., në vendin e quajtur „.’ ’ me sipërfaqe 11502m², evidentohet në emër të KBI „Progres ’ ’ ½ dhe H B ½ D.

Ngastra nr., në vendin e quajtur „.’ ’ me sipërfaqe 5294m², evidentohet në emër KBI Progres ZKD.

Ngastra nr. ..., në vendin e quajtur „.’ ’ me sipërfaqe 362m², evidentohet në emër M S, ZK D.

Ngastra nr., në vendin e quajtur „.’ ’ me sipërfaqe 335m², evidentohet në emër të T S ZK D.

Ngastra nr., në vendin e quajtur „.’ ’ me sipërfaqe 280m², evidentohet në emër të S S ZK D.

Ngastra nr., në vendin e quajtur „.’ ’ me sipërfaqe 262m², evidentohet në emër B S ZK D.

Gjykatës nuk u është dorëzuar asnjë vërejtje në lidhje me raportin e ekspertit të gjeodezisë.

Gjykata vlerëson se në bazë të provave të dorëzuara është vërtetuar fakti se ngastrat e identifikuar si më lart nr., .., dhe .. të evidentuara në fletën e posedimit nr. ..., ZK D kanë qenë objekti i kontratës së dhurimit të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren, Vr., dt., ndërsa ngastrat nr. ..., .., .., kanë qenë objekti i shitblerjes sipas kontratës të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren Vr., dt., pra të lidhura nga paraardhësi i paditësit dhe KBI Progres – të paditurës .

Gjykata vlerëson se paditësi nuk ka provuar se kontratat Vr., dt. dhe Vr., dt., janë shpallur nule me ndonjë vendim gjyqësor në pajtime legjislacionin në fuqi të kohës .

Gjykata vlerëson se paditësi nuk ka provuar bazën juridike të kërkesës pronësore me të cilën kërkon të vërtetohet e drejta e pronësisë në ngastrat lëndore, kështu që në momentin kur këto

prona janë bartur në emër të NSH – KBI Progres nga paraardhësi i paditësit me tjetërsim paraardhësi i paditësit e ka humbur pronësinë.

Në procedurën e likuidimit me rastin e shqyrtimit të ankesave/ kërkesave kundër Vendimit të AL , paditësi/ parashtruesi i ankesës sipas parimit të barrës së provës në kuptim me nenin 31.5 të Ligjit nr. 06/L-086, ka për obligim të vërtetohet se procesi i privatizimit nuk është kryer në mënyrë të rregullt, sipas nenit 74.2 të Ligjit nr. 06/L-086, pasi nuk vërtetoi me anjë provë materiale se procesi i privatizimit nuk është kryer sipas Ligjit nr. 04/L-043, kjo për faktin se paditësi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka titull juridikë për ngastrat lëndore, ndërsa e paditura KBI „Progres ” DLB Lavërtari dhe Blegtori, të drejtën e pronësisë e ka fituar në bazë të punës juridike – kontratave dhe e ka regjistruar të drejtën e pronësisë në regjistrin kadastral në vitin 1964,

Prandaj duke u mbështetur në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe juridike, paditësi nuk ka argumentuar se ankesa/kërkesa e ushtruar kundër vendimit të AK PRN 009- 0323 është e bazuar dhe ju është cenuar ndonjë e drejtë pronësore, për këtë arsye ajo është refuzuar .

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe juridike në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, u vendos që secila palë ti heqë shpenzimet e veta të procedurës .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar Kryesues

Sylejman Shumolli , Gjyqtar

Murat Hulaj Gjyqtar